



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1073/1 prot.

Tiranë, më 02.04.2025

VENDIM

Nr. 03, datë 02.04.2025

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1073 prot., datë 27.03.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Spitalit “Villa Maria” sh.p.k..

Ankuesi, nëpërmjet kërkesave datë 18.12.2024 dhe 11.03.2025, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. *Procedura/protokolli i ndjekur nga stafi mjekësor i spitalit tuaj përpara marrjes së vendimit për kryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale ndaj shtetases/e ndjera*.
2. *Pse u ndryshua procedura e planifikuar nga vendosja e një baloni gastrik në një operacion të ngushtimit të stomakut (gastric sleeve surgery) dhe cilët faktorë mjekësorë e justifikuan këtë vendim? A është informuar pacienti mbi këtë ndryshim operacioni dhe a është e dokumentuar dhënia e pëlqimit nga pacientja dhe bashkeshorti i saj ?*
3. *Çfarë vlerësimesh para operacionale dhe vlerësimesh të rrezikut janë kryer për të siguruar që pacientja Julie Ann Stanford ishte një kandidat i përshtatshëm si për balonën e stomakut ashtu edhe për operacionin e ngushtimit të stomakut. A janë marrë në konsideratë nga stafi mjekësor i spitalit të dhënat shëndetësore dhe historiku mjekësor i pacientes?*

4. *Cilat protokolle dhe udhëzime janë ndjekur gjatë operacionit dhe a ka pasur ndonjë devijim nga praktikat standarde?*
5. *A kishte kualifikimet e nevojshme stafi mjekësor që monitoroi dhe ofroi kujdesin mjekësor pacientes Julie Ann Stanford pas operacionit, deri në momentin e ndërrimit jetë prej saj? Nga familjarët e të ndjerës pretendohet se pas operacionit pacientja nuk është asistuar nga mjekë të specializuar postoperativ por vetëm nga personeli ndihmës.*
6. *Të dhënat e plota të trajtimit mjekësor, duke përfshirë dokumentacionin paraoperativ, kirurgjik dhe postoperativ, që ka mbështetur procesin e vendimmarrjes dhe kujdesin e ofruar?*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi Spitali “Villa Maria” sh.p.k. nuk ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “*Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi....*”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative*”, ka verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative, Spitali “Villa Maria” sh.p.k..

Nga verifikimi paraprak, Spitali “Villa Maria” sh.p.k., është shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit J82416001G. Referuar ekstraktit të Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit, rezulton se Spitali “Villa Maria” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me 100% aksione private.

Objekti LDI është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 e ligjit të sipërcituar “*Autoritet publik*” do të konsiderohen:

- a) *është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj;*
- b) *janë shoqëritë tregtare ku:*

i) shteti zotëron shumicën e aksioneve;

ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike;

c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Gjithashtu në ankesën e depozituar nga ankuesi, kërkohet informacion mbi veprime konkrete të kryera nga stafi i Spitalit “Villa Maria” sh.p.k., ndërkohë që në pikën 2 të nenit 2 përcaktohet se: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”.

Për sa më sipër parashtruar, rezulton se Spitali “Villa Maria” sh.p.k., nuk është autoritet publik në kuptim të LDI. Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitetit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i LDI, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 1073 prot., datë 27.03.2025, të z. _____, kundër Spitalit “Villa Maria” sh.p.k., me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 02.04.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi